



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:095650

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05525459

C.nr.1569/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.A., A.D., B.P. dhe Z.V. që të gjithë nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. A.A.dhe av. B.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt të kontestit kompensimi i shpërblimit prej 8.3 % të pagës vjetore kumulative, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 29 mars 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditëses A.A., A.D., B.P. dhe Z.V. nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar që të: *“DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit të parë A.A. nga Prizreni për vitin 2021 në emër të shpërblimit prej prej 8.3 % të pagës, të ia paguaj mjetet në shumë prej 419.28 euro, paditëses së dytë A.D. nga Prizreni për vitin 2021 në emër të shpërblimit prej prej 8.3 % të pagës, të ia paguaj mjetet në shumë prej 419.28 euro, paditëses së tretë B.P. nga Prizreni për vitin 2021 në emër të shpërblimit prej prej 8.3 % të pagës, të ia paguaj mjetet në shumë prej 419.28 euro, paditësit të katërt Z.V. nga Prizreni për vitin 2021 në emër të shpërblimit prej prej 8.3 % të pagës, të ia paguaj mjetet në shumë prej 419.28 euro, apo në shumën e përgjithshme prej 1,677.12 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore”.*
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

A.A., A.D., B.P. dhe Z.V. që të gjithë nga Prizreni më datë 24.04.2022, përmes të autorizuarve të tyre, kanë paraqitur padi, kundër të paditurës Komuna e Prizreni-

Drejtoria e Arsimit në Prizren, me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit prej 8.3 % të pagës, vlera e kontestit 1,677.12 euro.

Të autorizuarit e paditësve kanë theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune si mësimdhënës në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Planjane" në fshatin Planjanë, Komuna e Prizrenit. Bazuar në Kontratën Kolektive të vitit 2021, e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021, këtu paditësit kanë plotësuar kushtet që në bazë të nenit 35, paragrafi 11 të kësaj kontrate, punëdhënësi Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren të ua kompensoi shpërblimin në lartësi të 8.3 % të pagës. E paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj në bazë të dispozitës së lartcekur. Paditësit, përmes të autorizuarve të tyre kanë parashtruar kërkesë pranë të paditurës, mirëpo me vendimin e datës 08.04.2022, e ka refuzuar kërkesën e paditësve me arsyetimin se kontrata kolektive nuk gjen zbatueshmëri në Ministrinë e Financave. Andaj, në fund gjykatës i ka propozuar që të aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses së saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësës lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës. Po ashtu ka theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit - SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtare e sindikatës. Sipas saj, të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.07/L-041. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësës është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Po ashtu, sipas të paditurës e drejta për kompensim të pagës prej 8.3%, për vitin 2017 dhe deri me datën 17.05.2022, është parashkruar, duke u mbështetur në nenin 353 të LMD-së. Në fund ka kërkuar nga gjykata, që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësës ta refuzojë si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga e paditura, në kuptim të nenit 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është tërësisht e pabazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, mësimdhënëse në SHFMU “Planjane” në fshatin Planjanë, Komuna e Prizrenit, fakt

i cili nuk është kontestuar as nga ana e të paditurës dhe gjen mbështetje në listën e pagave të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është nëse paditëses i takon e drejta për kompensimin i shpërblimit prej 8.3 % të pagës.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të protokollit 105, të datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 dhe në rastin konkret pati parasysh nenin 35 par. 11, ku është përcaktuar se “punëtorëve (anëtarë të SBASHK-ut) në fund të çdo viti kalendarik u jepet shpërblim në lartësinë prej 8.3 % të pagës vjetore komulative, nga momenti që MASH, SBASHK dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave do të siguronin mjete financiare për kompensim. Zbatimi i kësaj mase lidhet me përmirësimin e performancës së sistemit (për shembull përmes rezultateve të përmirësuar në testin PISA dhe teste relevante të standardizuara ndërkombëtare), të institucionit ose të mësimdhënësve individual sipas vlerësimit të punëdhënësit”.

Sipas vlerësimit të gjykatës, dispozita e lartcekur KKAK-së, lidhur me kompensimin prej 8.3 % të pagës vjetore komulative, nuk paraqet normë të karakterit detyrues, pasi që paraprakisht duhet të sigurohen mjetet financiare për këtë lloj të kompensimit, e që gjykata vlerëson që paraprakisht i padituri duhet të ketë mundësinë buxhetore (duke siguruar këto mjete). E po ashtu, gjykata vlerëson se paditësja nuk ka arritur që të vërtetojë edhe kushtin tjetër të paraparë në nenin 35, par. 11 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e që është përmirësimin e performancës së sistemit (për shembull përmes rezultateve të përmirësuar në testin PISA dhe teste relevante të standardizuara ndërkombëtare), që paraqet edhe kusht për zbatimin e kësaj dispozite ligjore, në të cilën është bazuar kërkesa e paditëses. Kjo duke u bazuar edhe në nenin 7 par. 1 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), ku është paraparë se “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”, dhe nenin 319 par. 1 të ligjit të lartcekur, i cili ka përcaktuar se “secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazën kërkimet dhe pretendimet e veta”. Andaj, gjykata duke vlerësuar bazën ligjore të lartcekur dhe gjendjen faktike të vërtetuar, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses duhet refuzuar si e pabazuar.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke iu referuar nenit 399 të LPK-së ku parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin

meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia". Ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se "kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura". Kështu, gjykata ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë shqyrtimit kryesor, të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, kjo sepse nga faktet e treguara në padi, dhe prapësimet e ngritura nga e paditura në përgjigjen në padi, rezulton qartazi se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar.

Gjykata analizoi pretendimet e palëve në procedurë dhe provat tjera, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosje lidhur me këtë çështje juridike.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mori në bazë të nenit 450 të LPK-së, ashtu që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1569/2022, datë 29 mars 2024

Gjyqtari,
Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.